



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni vjeshtor*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.35/2018

Prishtinë, më 14 nëntor 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviç, Mexhide Mjaku-Topalli, Saranda Bogujevci, Shemsi Sylja, Fisnik Ismaili dhe Veton Berisha.

Stafi mbështetës i autorizuar i komisionit: Besim Haliti, zyrtar i lartë dhe Hana Bajraktari, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë Kosovare për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale; Haki Sadriu, Ibrahim Haxhiu, Selim Zyferi, Shoqata “27 Prilli 1999-Mejë”; Flora Kryeziu, UNICEF; Teuta Prekazi, “UN HUMAN RIGHTS”; Emine Shehu, “Ekonomia online”; Shqipe Pajziti, “Kosova Press”; Visar Shatrolli, RTK; Arbnor Gjinovci, “Ekonomia online”; Edon Baliqi, KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Raportimi në komision, lidhur me zhvillimin e punimeve në Kompleksin Memorial në Mejë. Të ftuar: përfaqësues të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale; Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe Shoqata e familjarëve të personave të zhdukur "27 Prilli 1999-Mejë".

Kryetarja, tha se nuk kemi kuorum, por për shkak se i kemi prezent të ftuarit, ne do t'i dëgjojmë, pasi që është edhe një temë shumë e ndjeshme.

Bislim Zogaj, tha se për rregullimin e tërësishëm të këtij kompleksi, punimet duhet të zhvillohen në tri faza. Edhe pse për rregullimin e këtij Kompleksi Memorial, puna është filluar para katër vitesh, me keqardhje, për shkak të disa mosmarrëveshjeve ndërmjet Shoqatës "27 Prilli- Mejë" nga Gjakova, shoqatë të cilin e kanë themeluar pjesëtarët e familjeve të atyre që janë të varrosur në këtë kompleks dhe kryerësit të punimeve në fazën e parë, që ende nuk janë përfunduar. Ai theksoi se shpreson që policia dhe prokuroria të ndihmojë në zgjidhjen e këtij problemi. Kompania e cila ka pasur për obligim që t'i vendosë kapakët dhe emrat, nuk kanë qenë seriozë. Fotografitë kanë qenë të dobëta. Kjo është vrasje për së dyti. Kemi shkuar në kompaninë që është marrë me këtë punë dhe kam kërkuar që ose t'i përmirësojë, ose t'i heq ata gurë nga aty. Ashtu ka ndodhur, i kanë hequr ata gurë. Pas dy javësh i kam dhënë urdhër kontraktuesit që të bëjë një zgjidhje tjetër ose ta ndërpresë kontratën. Ata e kanë bërë këtë. Fatkeqësisht, ende nuk i kemi siguruar fotografitë. Kompania ka thënë që brenda dy javësh do të mbyllet kjo çështje. Besoj se edhe policia, edhe prokuroria do të na ndihmojë, nëse ka nevojë, për të marrë fotografitë. Sipas tij, në vitin 2021 do të përfundojnë punimet në këtë kompleks.

Haki Sadriu, problemi qëndron te dy kompani, të cilat kanë mosmarrëveshje dhe fotografitë e personave të zhdukur po mbahen nga njëra prej tyre, për shkak të mospajtimeve që kanë. Luhet me fotografitë e personave të pagjetur. Nuk e di çka duhet tjetër të kontestohet, kur luhet me të drejtën e familjarit. Jemi në situatën më kritike, për faktin se familjarëve mund t'u humbë durimi dhe për këtë çështje, më pas, ne nuk mund të bartim përgjegjësi.

Deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, tha se rregullimi i duhur dhe kualitativ i punimeve në Kompleksin Memorial në Mejë, është përgjegjësi e secilit dhe që të gjithë bashkë duhet ta përmbyllin këtë çështje. Sot, do të ishte mirë të flasim për rezultate, e jo për diçka tepër shqetësuese. Më e pakta, që nuk e kisha pritur, është kjo dhimbja e trefishtë, është dhimbje për të gjithë. Pasi ka shkuar rasti në prokurori, të mos ndalet, por edhe ne, nga këtu do të dalim në përfundim, ta diskutojmë në komision që sa më parë çështja e fotografive, që është aset i familjeve, është shkelje e të drejtave elementare të njeriut, do të zgjidhet, ka thënë Haxhiu.

Luljeta Veselaj-Gutaj, ka apeluar që policia dhe prokuroria të merret me këtë çështje, urgjentisht. Ne fillimisht, si qytetarë, pastaj si deputetë apelojmë që sa më parë policia dhe prokuroria të merret me këtë çështje. Nuk guxojnë të luajmë me ndjenjat e atyre familjarëve që nuk e dinë as nga i kanë eshtrat e të dashurve të tyre, ka thënë Veselaj.

Mirjeta Kalludra, tha se duhet të bëhet presion te kompanitë, që ata t'i zgjedhin mosmarrëveshjet që i kanë mese vete dhe që fotografitë të kthehen dhe mos të luhet me ndjenjat e familjarëve dhe Kompleksi Memorial në Mejë të kryhet ashtu siç është paraparë me projekt.

Ibrahim Haxhiu, tha se janë kokulur para familjarëve, ndërsa ka fajësuar shtetin për këtë parregullsi. Ai ka thënë se po ta dinte se do vinte në këtë gjendje, nuk do ta linte djalin të varrosej në atë kompleks. "Nuk e di me çfarë të drejte morale na mbajnë fotografitë, më ka thënë që projekti nuk ka ndryshuar nga një milion e 600 mijë euro. Që vjen kjo situatë, që

bëhet kjo lojë e pandershme, e kemi menduar një Kosovë pa këto të meta që i ka sot, ne jemi në hall.

Bislim Zogaj, tha se me rëndësi është që kapakët dhe emrat të vihen. Buxheti është i përcaktuar për tri vjet. Jam i bindur se do të kryhen para kohe, ka thënë Zogaj.

Kryetarja falënderoi të pranishmit dhe tha se shpreson që ky problem të zgjidhet sa më parë, dhe si komision, gjithnjë jemi të gatshëm të japim kontributin në zgjidhjen e problemit. Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje